



Nr..... prot

Tiranë më 12.03.2020

Drejtuar: Znj. Anila DENAJ
Ministre,
Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Për Dijeni: Znj. Delina IBRAHIMAJ
Drejtoreshë
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Për Dijeni: Z. Edi RAMA
Kryeministër i Republikës së Shqipërisë

E nderuar zonja Ministre,

Ne vlerësojmë dhe mbështesim të gjitha veprimet dhe aktivitetin e ndërmarrë nga Qeveria Shqiptare dhe ju, në lidhje me masat për përballimin e situatës së rëndë të krijuar nga përhapja e Coronavirusit në Shqipëri. Është detyrë e të gjithë neve, që të bëjmë të pamundurën që së bashku të përballojmë këtë situatë.

Sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" shoqëritë shqiptare tatimpaguese duhet që brenda datës 31 Mars 2020, të bëjnë deklarimin e FDP të tatimit mbi të ardhurat si dhe të dorëzojnë në administratën tatimore elektronikisht Pasqyrat Financiare për vitin fiskal 2019..

Në këtë situatë emergjente në emër të Institutit të Kontabilistëve të Miratuar të Shqipërisë, anëtar i IFAC, ne do të kërkonim prej jush që të shikohet mundësia e shtyrjes të afati të dorëzimit të deklaratës të tatimit mbi të ardhurat dhe të Pasqyrave Financiare nga shoqëritë shqiptare tatimpaguese për vitin fiskal 2019.

Ne e konsiderojmë që kjo shtyrje është e domosdoshme për një sërë arsyesh:

1. Për shkak të situatës emergjente të epidemisë së COVID-19 Qeveria Shqiptare ka kërkuar kufizime të kontakteve mes njerëzve, kufizime të shërbimeve institucionale, mundësisht qëndrime në shtëpi në të mirë të shëndetit të gjithë popullsisë Shqiptare. Po ashtu ka kërkuar edhe mbylljen e bareve dhe restoranteve në Tiranë dhe Durrës, transportit urban në këto qytet, etj. masa parandaluese.
2. Shumë shoqëri shqiptare e kanë kufizuar shumë aktivitetin ose e kanë ulur ndjeshëm kontaktet me të tretët në kuadër të plotësimit të kërkesave të qeverisë Shqiptare por edhe për të evituar maksimalisht përhapjen e virusit vdekjeprurës.



3. Në kuadër të plotësimit të kërkesave të qeverisë edhe anëtarët tanë Kontabilistë të Miratuar por edhe ata që punojnë në shoqëritë Shqiptare, nën përgjegjësinë për të ruajtur veten dhe të tjerët, e kanë kufizuar në maksimum lëvizjen dhe kontaktet, të cilat do të ishin të nevojshme për të realizuar procesin e ndërtimit të PF.

Pra si kemi përshkruar dhe më lart, në këto kushte emergjence kombëtare është shumë e vështirë bile e pamundur që të plotësohen detyrimi për të ndërtuar PF të vitit 2019 dhe deklarata e tatimit mbi të ardhurat brenda datës 31 Mars 2020.

Ndërkohë shtyrja e afatit të deklarimit të këtyre dokumenteve nuk është se ndikon në nivelin e të ardhurave tatimore të qeverisë pasi tatimit paraprak mbi fitimin do të vijojë të paguhet normalisht sipas njoftimeve të administratës tatimore.

Kërkesa e jonë për shtyrjen e afatit të deklarimit të të deklaratës së tatimit mbi fitin dhe të dorëzimit të PF për vitin 2019 është në kuadër të masave të marra nga Qeveria Shqiptare dhe të përballimit të kësaj emergjence kombëtare.

Duke shpresuar që kërkesa jonë të merret në konsideratë prej jush, duke gjetur zgjidhjen e duhur ligjore,

Urojmë që të gjithë së bashku të përballojmë me sukses këtë situatë.

Me nderime,

Prof. Dr. Sotiraq DHAMO

Kryetar i Këshillit të Drejtimit të IKM